



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prilpjen / Prilpato Received / Delivered	07-04	2022	2	viti god Year
Organ / Shpista Organ / Jedinita Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKP/MSH/1957/2022			1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 193/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani - Kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 193/2022, të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi pa numër nga Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike " vërejte me shkrim ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr. 193/2022 ,e datës 01.03.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET, vërejtja e datës 15.02.2022, për mes e-mailit e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



A r s y e t i m

Ankuesi me datë 01.03.2022, me numër protokoli 1090/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA, i ka shqiptuar vërejtje me shkrim përmes e-mailit të datës 15.02.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 07.03.2022, me numër protokoli 1245/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa me datë 15.03.2022, me numër protokoli 1374/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Tregtisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 193/2022 e datës 01.03.2022, me numër protokoli 1090/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me shkrim e datës 15.02.2022, e shqiptuar për mes e-mailit; nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA; e-maili i datës 11.02.2022; Komunikimi i mesazheve në telefon, i ankuesit dhe Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit i datës 01.10.2019; Përshkrimi i detyrave të punës; e-maili i datës 14.02.2022, dërguar nga e-maili i datës 11.02.2022, i e-maili i datës 14.02.2022; e-maili i datës 15.02.2022, nga dërguar e-maili i datës 15.02.2022, dërguar nga për Komunikim për mes mesazheve në telefonit, me mes dhe ankuesit; e-maili i datës 14.02.2022; e-maili i datës 31.01.2022; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2022, me numër protokoli 1374/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar ,sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vërejtja e datës 15.02.2022, përmes e-mailit, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe pasi ka analizuar dhe shqyrtuar provat relevant lidhur me vërejtjen me shkrim për mes e-mailit të datës 15.02.2022, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar në ligj.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat nëni 48, paragrafi 1 dhe, nën paragrafi 1. 2 Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se "1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi"

prandaj bazuar në këtë dispozitë ligjore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se vërejtja me shkrim e ankuesit e shqiptuar, është dhënë pas një arsyetim të qartë me të cilën kishte për të kuptuar edhe ankuesi se cila është arsye e shqiptimit të vërejtjes.

Kolegji sipas shkresave të lëndës ka gjetur disa komunikime në mes ankuesit dhe Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm, por që këto komunikime nuk kanë bërë të qartë për Kolegjin se cili është fakti apo rrethana që ka përcaktuar se ankuesit duhet ti shqiptohet vërejtje me shkrim.

Kolegji po ashtu konstaton se edhe pse e-mali zyrtar shërben për komunikime megjithatë vërejtja duhet të plotësoj kushtet formale sipas dispozitave ligjore në fuqi me qëllim që palës të jepet mundësia se në cilën apo cilat pika duhet të korrigjohet në atë ardhmen.

Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e përmbajtjes së kësaj lënde sepse shkeljet procedurale kanë qenë të tilla që kanë kushtëzuar që ankesa e ankuesit të aprovohet.

Organi i punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është e obliguar që pas këtij vendimi të Këshillit, të ndërmarrë veprimin që nga dosja e ankuesit të largohet vërejtja e datës 15.02.2022, përmes e-mailit të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA, duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.NR. 193/2022**

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

Arkivit të KPMSHCK-së,